



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	10.11.17	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	60/01-3477 v.
Shtojcë			

Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

-Shërbimi i Kuvendit-

KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK

SHËRBIMI PËR PUNË PROFESIONALE TË KUVENDIT

BULETINI

PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS
PERIUDHA: 20.12.2013 DERI ME ZGJEDHJET LOKALE TË
DATËS 22 TETOR 2017

Kaçanik, 2017

HYRJE

Ky Buletin përfshinë Aktivitetin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, të Legjislaturës së V, i dalë nga Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 03 Nëntor 2013, respektivisht periudhën nga Inaugurimi i Kuvendit të Komunës 20.12.2013 deri më Zgjedhjet Lokale të datës 22 Tetor 2017.

Buletini është përpiluar nga Shërbimi për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës.

Bazë për përpilimin e këtij Buletini kanë shërbyer Procesverbalet e përpiluara gjatë punës së Kuvendit dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm që posedon Shërbimi i Kuvendit.

Të dhënat për, Rezultatet zgjedhore janë marrë nga : Faqja Zyrtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës.

Të dhënat për Ekzekutivin e Komunës, data e emërimeve dhe ndryshimet që janë bërë në ekzekutiv, janë marrë nga: Shërbimi i Personelit.

Qëllimi i këtij Buletini është pasqyrimi i aktivitetit të Kuvendit të Komunës për gjatë kësaj periudhës katërvjeçare, sistemimi i tyre dhe njoftimi i strukturave komunale në drejtim që të jetë sa më transparent aktiviteti i zhvilluar.

Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit është mirënjohës për vërejtjet dhe sugjerimet që do të jepen në të. Këto vërejtje dhe sugjerime do të ndihmojnë që aktiviteti i Kuvendit të Komunës në punën e ardhshme të jetë sa më i suksesshëm dhe cilësor.

Të përgjithshme

Me 15 Qershor 2008 ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës si akti më i lartë juridik i vendit.

Në kapitullin X të Kushtetutës janë përcaktuar. Parimet e përgjithshme të vetëqeverisjes lokale, organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale.

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi i Republikës së Kosovës, përveç tjerash ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-040. -Për Vetëqeverisjen Lokale (LVL).

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Organet e Komunës janë :

1. Kuvendi i Komunës ; dhe
2. Kryetari i Komunës.

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës në komunë, zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët e komunës.

Kuvendin e Komunës e udhëheqë Kryesuesi i Kuvendit i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Kuvendit, me shumicë votash, me votim të fshehtë.

Organi më i lartë Ekzekutiv i Komunës është: Kryetari i Komunës, zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët e komunës.

Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës funksionojnë në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës dhe akteve tjera nënligjore.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës Kaçanik, ka përbërje 27 anëtarë. Mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është, 4 Vite.

Kuvendi i Komunës mban së paku 10 Mbledhje brenda 1 viti, 5 prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit.

Takimet e Kuvendit të Komunës dhe të gjitha komisioneve të tij janë të hapura për publikun.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës themelon dy komitete të përhershme:

1. Komitetin për Politikë dhe Financa dhe
2. Komitetin për Komunitete.

Kuvendi i Komunës mund të themelon edhe komitete tjera sipas nevojës.

Zgjedhje Lokale 2013

Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës janë mbajtur me datë 03 Nëntor 2013

Në këto Zgjedhje është votuar për;

1. Kuvendet Komunave; dhe
2. Kryetarë të Komunave.

1. Në Komunën e Kaçanikut, për Kuvend të Komunës kanë kandiduar këto subjekte politike për 27 ulëse;

Emri i Partisë	Votat	Përqindja	Numri i vendeve të fituara
1. PDK- Partia Demokratike e Kosovës	5.589	39,98%	11
2. AAK-LDD Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	2.716	19,43%	5
3. LDK-.Lidhja Demokratike e Kosovës,	1.895	13,56%	4
4. Lëvizja Vetëvendosje,	1.337	9,56%	3
5. PD-Partia e Drejtësisë,	845	6,04%	2
6. AKR-Aleanca Kosova e Re,	727	5,20%	1
7 Bashkimi Demokratik për Kaçanikun,	667	4,77%	1
8. Hajrulla Shehu.	203	1,45%	0

2. Në Komunën e Kaçanikut, për Kryetar Komune kanë kandiduar :

Emri dhe Mbiemri	Emri i Partisë	Votat	Përqindja
1. Besim Ilazi	PDK- Partia Demokratike e Kosovës	8.056	52,64%
2. Tahir Çaka	AAK-LDD Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	2,741	17,91%
3.Selim Reka	LDK-.Lidhja Demokratike e Kosovës,	2.008	13,12%
4.Afide Kuka	Lëvizja Vetëvendosje,	1,179	7,70%
5.Avni Tafili	PD-Partia e Drejtësisë,	826	5,40%
6.Bardhyl Mjaku	AKR-Aleanca Kosova e Re	495	3,23%

Meqë Kandidati nga PDK- Partia Demokratike e Kosovës, Besim Ilazi ka fituar numrin e votave 52,64% , mbi 50 % në Rundin e parë të votimit, ka fituar të drejtën me marrë mandatin me udhëhequr me Komunën e Kaçanikut për 4 vjet, në pozitën e zgjedhur, **Kryetar i Komunës së Kaçanikut.**

PËRBËRJA E KUVENDIT TË KOMUNËS
(Legjislatura e V)

Viti 2013

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut i dalë nga Zgjedhjet Lokale të datës 03 Nëntor 2013, numëron gjithsej 27 anëtarë, me këtë përbërje:

Nr. rend	Emri dhe Mbiemri	Subjekti politik	Pozita
1.	Xhelal Gashi	PDK	Anëtar
2.	Bajram Baftiri	PDK	Anëtar
3.	Ilaz Ceka	PDK	Anëtar
4.	Osman Krasniqi	PDK	Anëtar
5.	Sabedin Vishi	PDK	Anëtar
6.	Kemal Mërseli	PDK	Anëtar
7.	Nexhat Loku	PDK	Anëtar
8.	Arbesa Berisha	PDK	Anëtare
9.	Pranverë Loku	PDK	Anëtare
10.	Arbnora Kuka	PDK	Anëtare
11.	Fitore Luzha	PDK	Anëtare
12.	Tahir Çaka	AAK	Anëtar
13.	Hajdar Loku	AAK	Anëtar
14.	Kadri Krivenjeva	AAK	Anëtar
15.	Lirije Qeli	AAK	Anëtare
16.	Sherife Troni	AAK	Anëtare
17.	Selim Reka	LDK	Anëtar
18.	Artan Shehu	LDK	Anëtar
19.	Nazife Krasniqi	LDK	Anëtare
20.	Lejla Koxha-Shehu	LDK	Anëtare
21.	Basri Kodra	LVV	Anëtar
22.	Raif Kasa	LVV	Anëtar
23.	Vlora Dema	LVV	Anëtare
24.	Avni Tafili	PD	Anëtar
25.	Lebibe Bela	PD	Anëtare
26.	Shukri Luta	BDK	Anëtar
27.	Samira Burrniku	AKR	Anëtare

Përbërja e Kuvendit të Komunës pasqyron përfshirjen e spektrit politik që kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe kanë fituar numrin e mjaftueshëm të votave.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, i Legjislaturës së V, i dalë nga Zgjedhjet e datës 03 Nëntor 2013, në përbërje 27 anëtarëve, përfaqësohet nga 7 subjekte politike, me numër të fituar të mandateve (ulëseve) si vijon:

1. Partia Demokratike e Kosovës (PDK),	11 mandate(ulëse);
2. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-Lidhja Demokratike e Dardanisë (AAK-LDD),	5 mandate (ulëse);
3. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK),	4 mandate (ulëse);
4. Lëvizja Vetëvendosje (LVV),	3 mandate (ulës);
5. Partia e Drejtësisë (PD),	2 mandate (ulëse);
6. Bashkimi Demokratik për Kaçanikun(BDK),	1 mandat (ulëse); dhe
7. Aleanca Kosova e Re (AKR),	1 mandat (ulëse).

INAUGURIMI (KONSTITUIMI) I KUVENDIT TË KOMUNËS (Legjislatura e V)

Viti 2013

Me 20 Dhjetor 2013, është mbajtur Mbledhja Inauguruese (Konstituive) e Kuvendit të Komunës, kryesuar nga anëtari me i vjetër i Kuvendit të Komunës, Osman Krasniqi, deri me zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, me këtë: Agjendë:

1. Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të kuvendit të komunës;
2. Fjala mirëseardhëse e Kryetarit të Komunës (në detyrë), Besim Ilazi;
3. Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës, Osman Krasniqi;
4. Dhënia e Betimit solemn i anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës;
5. Dhënja e Betimit Solemn i Kryetarit të rizgjedhur të Komunës, Besim Ilazi;
6. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të rizgjedhur të Komunës, Besim Ilazi;
7. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;
8. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të zgjedhur të Kuvendit të Komunës, Xhelal Gashi; dhe
9. Mbyllja e Seancës.

Mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të Komunës e ka thirrur dhe hapur Kryetari në detyrë i Komunës, Besim Ilazi.

Inaugurimi(Konstituimi) i Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, Organit më të Lartë vendimmarrës të Komunës, i dalë nga Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 03 Nëntor 2013, është bërë me 20 Dhjetor 2013, Kryesuar nga anëtari me i vjetër i Kuvendit të Komunës, Osman Krasniqi.

Në këtë mbledhje të gjithë anëtarët e zgjedhur të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut të paraqitur si në Listë, e dhanë Betimit dhe e Nënshkruan Deklaratës Solemne me 20 dhjetor 2013, dhe nga kjo datë i marrin zyrtarisht detyrën e anëtarit të Kuvendit të Komunës, duke u ngarkua me detyra, përgjegjësi dhe të drejta, sipas Ligjit Nr. 03/l-040 – Për Vetëqeverisje Lokale dhe Akteve tjera nënligjore.

Mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës, sipas nenit 37.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale është 4 vjeçar, ndërsa iu pushon sipas nenit 37 .2, a, b, c, d, e dhe f dhe 37.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Pas Inaugurimit(Konstituimit) të Kuvendit të Komunës, po në këtë mbledhje , data 20 Dhjetor 2013, e dha Betimin para Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, i dalë nga Zgjedhjet e 03 Nëntorit 2013.

Me dhënien e Betimit dhe Nënshkrimit të Deklaratës Solemne para Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës, ngarkohet me detyra dhe përgjegjësi për ta përfaqësuar Komunën e Kaçanikut dhe vepruar në emër të saj dhe përgjegjësitë tjera, të përcaktuara si në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Akteve tjera nënligjore.

Kryetari i zgjedhur i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, e merr zyrtarisht detyrën për të udhëhequr më komunën e Kaçanikut nga data 20.12.2013 për mandat 4 vjeçar. Mandati i Kryetarit të Komunës përfundon sipas dispozitave të nenit 56.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Në mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të Komunës, të datës 20 Dhjetor 2013, u zgjodh me votim të fshehtë me shumicë votash në Rundin e dytë të votimit, Xhelal Gashi, Kryesues të Kuvendit të Komunës, nga subjekti politik i PDK, subjekt ky i cili e ka numrin më të madh të ulëseve apo 11 sish.

Për zbatimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Kaçanik, u formua komisioni në përbërje:

1. Sabedin Vishi, nga PDK, kryesues,
2. Lejla Koxha-Shehu, nga LDK, anëtare, dhe
3. Kadri Krivenjeva, nga AAK anëtar.

Nga data 20 Dhjetor 2013, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, Xhelal Gashi e merr zyrtarisht detyrën për t'i kryesuar dhe udhëhequr Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, dhe sipas detyrës zyrtare i kryeson edhe mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mandati i Kryesuesit të Kuvendit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.

Përbërja e Kuvendit të Komunës Kaçanik në vitin 2014:

Nr. rend	Emri dhe Mbiemri	Subjekti politik	Pozita
1.	Xhelal Gashi	PDK	Kryesues
2.	Bajram Baftiri	PDK	Anëtar
3.	Ilaz Ceka	PDK	Anëtar
4.	Osman Krasniqi	PDK	Anëtar
5.	Sabedin Vishi	PDK	Anëtar
6.	Kemal Mërseli	PDK	Anëtar
7.	Nexhat Loku	PDK	Anëtar
8.	Arbesa Berisha	PDK	Anëtare
9.	Pranverë Loku	PDK	Anëtare
10.	Arbnora Kuka	PDK	Anëtare
11.	Fitore Luzha	PDK	Anëtare
12.	Tahir Çaka	AAK	Anëtar
13.	Hajdar Loku	AAK	Anëtar
14.	Kadri Krivenjeva	AAK	Anëtar
15.	Lirije Qeli	AAK	Anëtare
16.	Sherife Troni	AAK	Anëtare
17.	Selim Reka	LDK	Anëtar
18.	Artan Shehu	LDK	Anëtar
19.	Nazife Krasniqi	LDK	Anëtare
20.	Lejla Koxha-Shehu	LDK	Anëtare
21.	Basri Kodra	LVV	Anëtar
22.	Raif Kasa	LVV	Anëtar
23.	Vlora Dema	LVV	Anëtare
24.	Avni Tafili	PD	Anëtar
25.	Lebibe Bela	PD	Anëtare
26.	Shukri Luta	BDK	Anëtar
27.	Samira Burrniku	AKR	Anëtare

Me Kuvendin e Komunës udhëheq, Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Ndryshimet në Kuvendin e Komunës në spektrin politik etj. dhe Trupave Punuese, për gjatë mandatit 4 vjeçar

Përbërja e Kuvendit të Komunës si në listën e lartshënuar në ndërkohë pëson ndryshime me atë që, anëtari i zgjedhur i Kuvendit të Komunës nga PDK, Ilaz Ceka, pas një periudhe kohore me 12.09.2014, për shkak të një sëmundje të rëndë, ndërroi jetë, dhe në vend të tij me Vendim të KQZ, caktohet kandidati i radhës, Ramadan Dema nga subjekti politik i PDK.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi i Komunës ka pasur ndryshime edhe në përbërjen e spektrit politik, ashtu që anëtari, Basri Kodra nga LVV, me datë 24.09.2014 ka bërë Njoftim Kryesuesit të Kuvendit së ka ofruar dorëheqje nga subjekti politik i LVV për të vepruar në Kuvendin e Komunës, **Kandidat i Pavarur**.

Me vonë kemi edhe ndryshime tjera në spektrin politik, ashtu që nga subjekti politik i AAK, anëtarët e Kuvendit të Komunës: 1.Hajdar Loku, 2. Kadri Krivenjeva dhe 3. Lirije Qeli- Luta, kalojnë në subjektin politik të PDK. Njoftimin për kalimin e tyre në subjektin politik të PDK, këta tre anëtarë e kanë bërë tek, Kryesuesit të Kuvendit me datë: 23.12.2014.

Në vitin 2017- pak para përfundimit të mandatit të kësaj legjislature, kemi edhe ndryshime tjera në spektrin politik, ashtu që anëtarët nga Partia e Drejtësisë, Avni Tafili dhe Lebibe Bela, kalojnë në subjektin politik të Lëvizjes Vetëvendosje- LVV. Njoftimi i dy kandidatëve ishte bërë me shkrim dhe i njëjti u konfirmua edhe në Mbledhjen e V të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 25 Maj 2017.

Edhe dy anëtarët e Kuvendit të Komunës nga subjekti politik i AAK: Tahir Çaka dhe Sherife Troni, mësohet së kanë kaluar në subjektin politik të Partisë Demokratike të Kosovës, ndërkaq administrata nuk është ka pasur ndonjë, Shkresë njoftuese për kalimin e këtyre dy anëtareve në subjekt tjetër politik.

Trupat punuese të Kuvendit të Komunës dhe ndryshimet që kanë pësuar për gjatë periudhës 4 vjeçare

1.Komitetit për Politikë dhe Financa(KPF) është formuar me 31.01.2014:

Nr. ren.	Emri dhe Mbiemri	subjekti	pozita
1.	Xhelal Gashi	PDK	Kryesues sipas funksionit
2.	Sabedin Vishi	PDK	anëtar
3.	Arbnora Kuka	PDK	anëtare
4.	Tahir Çaka	AAK	anëtar
5.	Hajdar Loku	AAK	anëtar
6.	Selim Reka	LDK	anëtar
7.	Basri Kodra	LDK	anëtar

Në ndërkohë kjo përbërje pëson ndryshime, me atë që anëtari, Basri Kodra jep dorëheqje nga KPF, pasi që në Kuvend të Komunës pas dorëheqjes nga subjekti politik i LVV, vepron i Pavarur, ndërkaq ulësen në këtë komitet e ka marrë në emër të subjektit politik të LVV.

Në vend të Basri Kodra, me datë 31.10.2014 me Vendim të Kuvendit të Komunës emërohet për anëtar të KPF, **Raif Kasa nga Lëvizja Vetëvendosje –LVV**.

Me vonë edhe anëtari, Hajdar Loku, jep dorëheqje nga KPF, ndërkaq në vend të tij, me datë 31.07.2015, me Vendim të Kuvendit të Komunës, për anëtar të KPF, emërohet, **Avni Tafili nga Partia e Drejtësisë- PD**.

2. Komiteti për Komunitete, formuar me 31.01.2014:

Nr. ren.	Emri dhe Mbiemri	subjekti	pozita
1.	Kadri Krivenjeva	AAK	Kryesues
2.	Nazife Krasniqi	LDK	anëtare
3.	Vlora Dema	LVV	anëtare
4.	Elmihane Malsiu	Shoqëria civile/ HANDIKOS	anëtare
5.	Shemsedin Abazi	Shoqëria civile KMLDNJ	anëtar

Më vonë kjo përbërje pëson ndryshime, ashtu që Kadri Krivenjeva jep dorëheqje nga ky komitet dhe në vend të tij, me Vendim të Kuvendit të Komunës të datës 31.07.2015, në këtë komitet emërohet **Pranverë Loku nga subjekti politik i PDK**, ndërkaq me Vendim të Komitetit për Komunitete, për Kryesuese të këtij komiteti, zgjidhet, **Nazife Krasniqi nga LDK**.

3. Komiteti për Shërbime Publike, i formuar me 31.10.2014:

Nr. rend.	Emri dhe Mbiemri	subjekti	Pozita
1.	Kemal Mërseli,	PDK	Kryesues
2.	Arbesa Berisha	PDK	anëtare
3.	Sherife Troni	AAK	anëtare
4.	Lejla Koxha-Shehu	LDK	anëtare
5.	Avni Tafili	PD	anëtar

Me vonë, kjo përbërje pëson ndryshime, në atë që pas dorëheqjes së Avni Tafili, i cili është emëruar anëtarë në KPF, në vend të tij, me Vendim të Kuvendit të Komunës të datës 30.03.2016, emërohet për anëtare në Komitetit për Shërbime Publike, **Lebibe Bela nga Partia e Drejtësisë (PD)**.

Përbërja e Ekzekutivit të Komunës në vitin 2014:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita
1.	Besim Ilazi	Kryetar i Komunës
2.	Remzi Elezi	Nënkryetar i Komunës
3.	Burim Çaka	drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme(DAP),
4.	Besnik Salihu	drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale(DSHMS)
5.	Bahri Selimi	drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim(DEFZH)
6.	Enver Kamishi	drejtor i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë(DAK)
7.	Hajredin Shehu	drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit(DUKMM)
8.	Shkelqim Jakupi	drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë(DSHPE)
9.	Zylfi Koxha	drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari(DBZHRP)

Me Ekzekutivin e komunës udhëheqë, Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

Emërimet dhe Ndryshimet në Ekzekutivin e Komunës për gjatë Periudhës 4 vjeçare

Emërimet për; Nënkryetar të Komunës dhe për 07 Drejtorë të Drejtorive Komunale të përcaktuara si me lartë të, janë bërë me Vendime të Kryetarit të Komunës me datë : 08.01.2014.

Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Hajredin Shehu, Shkelqim Jakupi dhe Besnik Salihu, janë nga subjekti politik i LDK, ndërsa 4 drejtorët e Drejtorive tjera të komunës janë nga subjekti politik i PDK.

Ky përfaqësim është bërë në bazë të një Marrëveshje Politike të cilën e kanë bërë dy subjektet politike në Koalicion: PDK-LDK, ku subjekti politik i LDK, në bazë të Marrëveshjes së lidhur, udhëheq me tri drejtori, ndërsa subjekti politik i PDK, udhëheq me 4 drejtori.

Në ndërkohë, kjo përbërje pëson ndryshime për shkak se tre anëtarë të Kuvendit të Komunës nga subjekti politik i AAK kalojnë në subjektin politik të PDK, kështu subjekti i PDK i bënë votat e mjaftueshme apo 14 votë, për të udhëhequr me Kuvendit e Komunës. Për këtë arsye subjekti politik i PDK e prishi Marrëveshjen e Koalicionit me LDK, kështu i marrin edhe tri drejtoritë që i udhëheqtë LDK, për t'i udhëhequr nga vet PDK-a.

Në ndërkohë nga Ekzekutivi i Komunës, me Vendim të Kryetarit të Komunës, hiqen drejtorët e drejtorive komunale; Shkëlqim Jakupi- drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, me datë: 31.03.2015; Besnik Salihu – drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale me 09.03.2015 ; dhe Hajredin Shehu- drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, me datë: 04.03.2015.

Me këtë rast, Kryetari i Komunës merr Vendim për emërimin e këtyre drejtorëve të drejtorive komunale:

1. **Diana Bajrami-Reka**, e emëron për drejtoreshë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, 23.03.2015;
2. **Fatos Koxha**, emërohet, u. d. i drejtorit në Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, 23.03.2015;
3. **Ramadush Osmani**, emërohet drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, me 01 Prill 2015.

Me datë 25.03.2016 me Vendim të Kryetarit të Komunës, Fatos Koxha – hiqet nga pozita e u.d. drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, me Vendim të Kryetarit emërohet, në vitin 08.04. 2016, **Ukshin Qallaku**.

Pak para përfundimit të mandatit të Ekzekutivit të Komunës edhe kjo përbërje pëson ndryshime, ashtu që, drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, Burim Çaka, ofron dorëheqje nga pozita e drejtorit të drejtorisë për shkak të punësimit të tij në Gjykatë Themelore në Ferizaj-dega në Kaçanik.

Vendimi për aprovimin e dorëheqjes së tij u bë me Vendim të Kryetarit të Komunës me 28 Korrik 2017, ndërkaq nga kjo datë, punët dhe detyrat e punës së drejtorit të DAP i kryen Nënkryetari i Komunës Remzi Elezi, krahas punëve dhe detyrave të punës të nënkryetarit të komunës.

AKTIVITETI I KUVENDIT TË KOMUNËS
(Legjislatura e V)

Viti 2014

Mbledhja I

Me 30.01.2014, është mbajtur mbledhja e I e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në përbërje:
 1. Xhelal Gashi, PDK, Kryesues sipas funksionit,
 2. Arbnora Kuka , PDK, anëtare,
 3. Sabedin Vishi , PDK, anëtar
 4. Tahir Çaka, AAK , anëtar,
 5. Hajdar Loku, AAK, anëtar,
 6. Selim Reka, LDK , anëtar dhe
 7. Basri Kodra, LVV, anëtar.
3. Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;
 1. Kadri Krivenjeva, AAK, anëtar,
 2. Nazife Krasniqi, LDK, anëtare,
 3. Vlora Dema, LVV, anëtare,
 4. Elmihane Krasniqi-Malsiu, SHC-HANDIKOS, anëtare dhe
 5. Shemsedin Abazi, KDMLNJ anëtar.Kryesuesi i këtij Komisioni zgjidhet nga radhët e anëtarëve.
4. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2014;
5. Vendimi për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga viti 2012 dhe 2013, në vitin 2014;
6. Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm për zgjerimin e fushës së futbollit dhe fushë ndihmëse;
7. Vendimi për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës;
8. Vendimi për ndarjen e bursave të studentëve të Komunës së Kaçanikut për vitin akademik 2013/2014; dhe
9. Vendimi për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura nga qytetarët e komunës së Kaçanikut.

Mbledhja II

Me 28.02.2014, është mbajtur mbledhja e II (Dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Ekzekutivit të komunës, për vitin 2014;
3. Vendimi për Aprovimin e Raportit Vjetor Financiar- për vitin e përfunduar me 31.12.2013;
4. Vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Kaçanikut, për vitin akademik 2013/2014;
5. Vendimi për Rishqyrtimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive;
6. Vendimi për ndryshim plotësimin e nenit 9 të Rregullores për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve të tjera komunale 01Nr. 05-4236/10;
7. Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e një Rregulloreje për caktimin e vijës rregulluese, vijës së ndërtimit si dhe kushteve tjera ndërtimore, në pjesët ku ekziston Plani rregullues urban, deri me miratimin e Planeve Rregulluese Urbane;
8. Vendimi për themelimin e një komisioni për gjetjen e alternativave të lokacionit për varrezat e qytetit në komunën e Kaçanikut;
9. Vendimi për zgjidhjen përfundimtare të statusit të NKP "Lypoteni"; dhe
10. Vendimi për themelimin e komisionit të aksionarëve për KRM "Pastërtia", sh. a- Njësia në Kaçanik.

Mbledhja III

Me 31.03.2014, është mbajtur mbledhja e III (Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës,
2. Vendimi për destinimin e mjeteve financiare për realizimin e projekteve të drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, me Buxhetin e vitit 2014;
3. Vendimi për ndryshimin e destinimit të parcelës kadastrale 664 të Zonës Kadastrale Kaçanik, nga Plani Zhvillimor Urban i Kaçanikut nga destinimi, shërbime dhe banim individual, në zonën për banim kolektiv dhe afarizëm;
4. Vendimi mbi Vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për ndërtimin e Stadiumit të Qytetit;
5. Vendimi mbi Vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për ndërtimin e Stadiumit të Qytetit. Varrezat e Dëshmorëve dhe Varrezat e Qytetit;
6. Vendimi mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme nga prona shoqërore, Shoqëria Sportive "Lepenci", në Pronë Komunale, në përbërje;
7. Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në përbërje:
 1. Kryetari i Komunës - Kryesues,
 2. Komandanti i Stacionit Policor në Kaçanik,
 3. Përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik,
 4. Përfaqësuesi nga komunitetet etnik pakicë në komunë,
 5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete,
 6. Zyrtari për Barazi Gjinore,
 7. Drejtori i Drejtorisë për Arsim,
 8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit,
 9. Përfaqësuesi i FSK-së,
 10. Përfaqësuesi i Këshillit Lokal për Siguri Publike,
 11. Kryesuesi i Ekipit Veprues Komunal për Siguri në Bashkësi,
 12. Përfaqësuesi nga Sektori Emergjencave Civile Komunale,
 13. Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
 14. Përfaqësuesi i OJQ-ve lokale,
 15. Përfaqësuesi i mediave lokale,
 16. Përfaqësuesi i bizneseve lokale,
 17. Përfaqësuesi nga komuniteti lokal i personave me aftësi të kufizuar.

Mbledhja e IV

Me 30.04.2014, është mbajtur mbledhja e IV (Katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2013;
3. Vendimi për Aprovimin e Raportit Financiar për periudhën janar-mars, 2014;
4. Vendimi për Aprovimin e Rregullores për Shërbime Publike;
5. Vendimi për formimin e komisionit të përkohshëm për plotësimin e emërimit të rrugëve lokale që nuk janë të emërtuara në komunën e Kaçanikut; dhe
6. Vendimi për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve për KRU” Bifurkacioni” sh. a. njësia në Kaçanik. Në këtë komision për anëtarë nga radhët e Kuvendit të Komunës emërohen:
 1. Sherife Troni, anëtar nga subjekti politik i AAK, dhe
 2. Selim Reka. anëtar nga subjekti politik i LDK.

Mbledhja e V

Me 27.06.2014, është mbajtur mbledhja e V (Pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për Aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut për vitet 2015-2017;
3. Vendimi për emërtimin e rrugëve të paemërtuara lokale në komunën e Kaçanikut;
4. Vendimi për Aprovimin e Planit të aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2014; dhe
5. Debatohet Problematika e Ujit të pijes në qytetin e Kaçanikut.

Mbledhja e VI

Me 18.07.2014, është mbajtur mbledhja e VI (Gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Buxhetit për periudhën janar-qershor, 2014;
3. Vendimi për Rishikimin Gjashtëmuor të Buxhetit të Komunës, për vitin 2014;
4. Raporti Final i Audtit të Përgjithshëm dhe Plani i Veprimit lidhur me Pasqyrat vjetore financiare, për vitin e përfunduar me 31.12.2013; dhe
5. Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar shkollave të komunës.

Mbledhja e VII

Me 10. 09.2014 është mbajtur mbledhja e VII (Shtatë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për Aprovimin e Rregullores për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2015;
3. Vendimi për rialokimin dhe transferin e mjeteve të projekteve kapitale sipas buxhetit të vitit 2014; dhe
4. Vendimi për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NKP “ Stacioni i Autobusëve” SH. A- Kaçanik. Në këtë komision për anëtarë nga radhët e Kuvendit të Komunës emërohen:
 1. Sabedin Vishi, PDK, dhe
 2. Hajdar Loku, AAK.

Mbledhja e VIII

Me 30.09.2014, është mbajtur mbledhja e VIII (Tetë) Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për miratimin e Buxhetit të komunës, për vitin fiskal 2015 dhe Vlerësimet për vitet, 2016-2017;
3. Informatë për përfundimin e vitit shkollorë, 2013/2014.

Mbledhja e IX

Me 31.10.2014, është mbajtur mbledhja e IX (Nëntë) të Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për aprovimin e Rregullores për Transportin Rrugor në Territorin e Komunës së Kaçanikut;
3. Vendimi për formimin e Komitetit për Shërbime Publike, në përbërje:
 1. Kemal Mërseli, PDK, anëtar,
 2. Arbësa Berisha, PDK, anëtare,
 3. Sherife Troni, AAK, anëtare
 4. Lejla Koxha-Shehu, LDK, anëtare, dhe
 5. Avni Tafili, PD, anëtar.
4. Vendimi për aprovimin e Raportit –IX- mujorë financiar, për periudhën, Janar-Shtator 2014,
5. Vendimi për ndryshim plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 16-2195/14, për ndarjen e bursave të studentëve të komunës,
6. Vendimi për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, ashtu që në vend të Basri Kodra, për shkak të dorëheqjes së tij, në KPF emërohet, Raif Kasa nga L.VV.

Mbledhja e X

Me 12.12.2014, është mbajtur mbledhja e X (Dhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për aprovimin e Rregullores për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale.

Mbledhja e XI

Me 30.12.2014, është mbajtur mbledhja e XI (Njëmbëdhjetë) të Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për Aprovimin e Planit të Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2015; dhe
3. Vendimi për Aprovimin e Planit të vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore në komunën e Kaçanikut.

MBLEDHJE SOLEMNE

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, gjatë vitit 2014, ka mbajtur tri mbledhje me karakter Solemn dhe atë: me datë 17.02.2014, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Me 11.06.2014, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Çlirimit të Komunës dhe më datë 10 gusht 2014, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Dëshmorëve të Komunës.

MBLEDHJE KOMEMORATIVE

Kuvendi i Komunës Kaçanik, me datë 13.09.2014, ka mbajtur një Mbledhje Komemorative në Përkujtim të jetës dhe veprës së anëtarit të ndjerë të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut nga subjekti politik i PDK, Ilaz Ceka, i cili ndërroi jetë me 12 shtator pas një sëmundje të rëndë. Mbledhja u mbajt në shtëpinë e kulturës "Xheladin Kurtaj" në Kaçanik, ku morën pjesë personalitete nga vendi dhe me gjerë. Po në këtë ditë është bërë edhe varrimi i të ndjerit, Ilaz Ceka.

DEBATE PUBLIKE

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, gjatë vitit 2014, ka organizuar dhe mbajtur Debate publike me qytetarë të komunës për çështje të përgjithshme janë mbajtur 2 Debate, dhe disa debate tjera për çështje të veçanta, si, për Buxhetin e komunës dhe për çështje tjera më rëndësi për komunën.

MONITORIMI I MBLEDHJEVE

Monitorimi i mbledhjeve të rregullta të kuvendit nga strukturat vendore është bërë nga MAPL-a, përmes Tel prezencës, ndërsa nga strukturat ndërkombëtare, mbledhjet e rregullta të Kuvendit, janë monitoruar nga OSBE-a.

PËRBËRJA E KUVENDIT TË KOMUNËS
(Legjislatura e V)

Viti 2015

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut i dalë nga Zgjedhjet Lokale të datës 03 Nëntor 2013, numëron gjithsej 27 anëtarë.

Kuvendi i Komunës i Legjislaturës së V, në vitin 2015, ka punuar me këtë përbërje:

Nr. rend	Emri dhe Mbiemri	Subjekti Politik	Pozita
1.	Xhelal Gashi	PDK	Kryesues
2.	Bajram Baftiri	PDK	Anëtar
3.	Ramadan Dema	PDK	Anëtar
4.	Osman Krasniqi	PDK	Anëtar
5.	Sabedin Vishi	PDK	Anëtar
6.	Kemal Mërseli	PDK	Anëtar
7.	Nexhat Loku	PDK	Anëtar
8.	Arbesa Berisha	PDK	Anëtare
9.	Pranverë Loku-Zharku	PDK	Anëtare
10.	Arbnora Kuka	PDK	Anëtare
11.	Fitore Luzha	PDK	Anëtare
12.	Tahir Çaka	AAK	Anëtar
13.	Hajdar Loku	PDK	Anëtar
14.	Kadri Krivenjeva	PDK	Anëtar
15.	Lirije Qeli- Luta	PDK	Anëtare
16.	Sherife Troni	AAK	Anëtare
17.	Selim Reka	LDK	Anëtar
18.	Artan Shehu	LDK	Anëtar
19.	Nazife Krasniqi	LDK	Anëtare
20.	Lejla Koxha-Shehu	LDK	Anëtare
21.	Basri Kodra	Pavarur	Anëtar
22.	Raif Kasa	LVV	Anëtar
23.	Vlora Dema	LVV	Anëtare
24.	Avni Tafili	PD	Anëtar
25.	Lebibe Bela	PD	Anëtare
26.	Shukri Luta	BDK	Anëtar
27.	Samira Burniku	AKR	Anëtare

Me Kuvendin e Komunës udhëheq, Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa(KPF) në vitin 2015;

Nr. ren.	Emri dhe Mbiemri	subjekti	pozita
1.	Xhelal Gashi	PDK	Kryesues sipas funksionit
2.	Sabedin Vishi	PDK	anëtar
3.	Arbnora Kuka	PDK	anëtare
4.	Tahir Çaka	AAK	anëtar
5.	Hajdar Loku	AAK	anëtar
6.	Selim Reka	LDK	anëtar
7.	Raif Kasa	LVV	anëtar

Në ndërkohë kjo përbërje pëson ndryshime, me atë që anëtari, Hajdar Loku, jep dorëheqje nga KPF, për shkak të kalimit të tij në subjektin politik të PDK, dhe në vend të tij, për anëtar të KPF, emërohet, **Avni Tafili nga Partia e Drejtësisë (PD)**.

Komitetit për Komunitete, në vitin 2015

Nr. ren.	Emri dhe Mbiemri	subjekti	pozita
1.	Kadri Krivenjeva	AAK	Kryesues
2.	Nazife Krasniqi	LDK	anëtar
3.	Vlora Dema	LVV	anëtare
4.	Elmihane Malsiu	Shoqëria civile/HANDIKOS	anëtar
5.	Shemsedin Abazi	Shoqëria civile KMLDNJ	anëtar

Me Komitetin për Komunitete udhëheqë, Kadri Krivenjeva, Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Me vonë kjo përbërje pëson ndryshime me atë që, Kadri Krivenjeva jep dorëheqje nga ky komitet dhe në vend të tij, caktohet **Pranverë Loku-Zharku- nga PDK**, ndërkaq **Kryesuese e Komitetit për Komunitete me Vendim të këtij komiteti, zgjidhet; Nazife Krasniqi.**

Komiteti për Shërbime Publike, në vitin 2015;

Nr. rend.	Emri dhe Mbiemri	subjekti	Pozita
1.	Kemal Mërseli,	PDK	Kryesues
2.	Arbesa Berisha	PDK	anëtare
3.	Sherife Troni	AAK	anëtare
4.	Lejla Koxha-Shehu	LDK	anëtare
5.	Avni Tafili	PD	anëtar

Ekzekutivi i Komunës në vitin 2015, kishte këtë përbërje:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita
10.	Besim Ilazi	Kryetar i Komunës
11.	Remzi Elezi	Nënkryetar i Komunës
12.	Burim Çaka	Drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme(DAP),
13.	Diana Reka	Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale(DSHMS)
14.	Bahri Selimi	drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim(DEFZH)
15.	Enver Kamishi	Drejtor i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë(DAK)
16.	Fatos Koxha	u.d. i Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit(DUKMM)
17.	Ramadush Osmani	Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë(DSHPE)
18.	Zylfi Koxha	Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari(DBZHRP)

Me Ekzekutivin e Komunës, udhëheqë Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

AKTIVITETI I KUVENDIT TË KOMUNËS (Legjislatura e V)

Viti 2015

Mbledhja I

Me 30.01.2015, është mbajtur mbledhja e I-r (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e XI-të e Rregullt e KK, për vitin 2014;
2. Vendimi për aprovimin e Planit të Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2015;
3. Vendimi për aprovimin e Planit të aktiviteteve të Komitetit për Komunitete, për vitin 2015;
4. Vendimi për aprovimin e Planit strategjik i veprimit të grupit të grave, për vitin 2015;
5. Vendimi për aprovimit të Rregullores për caktimin e orarit të punës së subjekteve afariste në territorin e komunës së Kaçanikut;
6. Shqyrtohet Kërkesa e MAPL për rishqyrtimin e Rregullores për pagesën e tarifave, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale; dhe
7. Vendimi për lejimin e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, për realizimin e projekteve të DAK, për vitin 2015.

Mbledhja II

Me 27.02.2015, është mbajtur mbledhja e II (Dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Aprovimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2014;
3. Aprovimi i Raporti Vjetor Financiar, për vitin 2014;
4. Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara në buxhetin e komunës për vitin 2015;

5. Vendimi për ndarjen e mjeteve për subvencione dhe transfere sipas buxhetit të komunës për vitin 2015;
6. Vendimi për destinimin e mjeteve financiare për realizimin e projekteve të drejtorisë së BZHRRP të parapara me buxhetin e vitit 2015;
7. Aprovimi i Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2014; dhe
8. Aprovimi i Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2014.

Mbledhja III

Me 01.04.2015 është mbajtur mbledhja e III (Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për aprovimin e Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave të studentëve të komunës;
3. Vendimi për rregullimet buxhetore të pagave dhe mëditjeve sipas buxhetit të komunës për vitin 2015;
4. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës, 01Nr. 463-11 të datës 20 shkurt 1986, për dhënien në shfrytëzim të përhershëm pasurinë e paluajtshme, Organizatës Punuese "Saniteks" nga Klladusha e Madhe, pa kompensim.
5. Njoftohet KK lidhur me dorëheqjen e dy anëtarëve të Komiteteve obliguese të KK, Hajdar Loku nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kadri Krivenjeva nga Komiteti për Komunitete.

Mbledhja e IV

Me 28.04.2015, është mbajtur mbledhja e IV (Katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për aprovimin e Raportit financiar për periudhën, janar-mars 2015;
3. Vendimi për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik, për vazhdimin e ndërtimit – rregullimin e shtratit të lumit Nerodimja në Kaçanik;

4. Vendimi për dhënien e Pëlqimit kompanisë “AFA ENERGY” sh.p.k nga Prishtina, për ndërtimin e Hidrocentralit 2.4 MW në vendin, Reka e Kotlinës në f. Kotlinë;
5. Vendimi për dhënien e Pëlqimit kompanisë “2 Korriku” sh.p.k. nga f. Soponicë, për ndërtimin e Hidrocentralit “ Soponica” me kapacitet 1.3 MW në lumin Lepenc në fshatrat, Soponicë dhe Doganaj;

Mbledhja e V

Me 29.05.2015, është mbajtur mbledhja e V e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Rregullor për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr. 16-3317/15 të datës 30.01.2015 Për pagesën e tarifave, ngarkesave, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale;
3. Propozim Vendimi për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik, për vazhdimin e ndërtimit –rregullimin e shtratit të lumit Lepenc në Kaçanik;
4. Vendimi për ndryshim plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 400-2428/15 për realizimin e projekteve të drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës; dhe
5. Vendimi për Rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2015.

Mbledhja e VI

Me 30.06.2015 është mbajtur mbledhja e VI (Gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për aprovimin e Kornizës afatmesme buxhetore e komunës së Kaçanikut, për vitet 2016-2018;
3. Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Qamil Ilazi – “ Komandant Bardhit”; dhe
4. Vendimi për formimin e komisionit për dhënien e pronës publike të komunës në shfrytëzim, në këtë përbërje:
 1. _____ caktohet nga Kryetari i Komunës,
 2. _____ caktohet nga Kryetari i Komunës,
 3. _____ caktohet nga Kryetari i komunës.
 4. Nexhat Loku, anëtar i kuvendit nga PDK,
 5. Selim Reka, anëtar i kuvendit nga LDK,
 6. Tahir Çaka, anëtar i kuvendit nga AAK, dhe
 7. _____ nga shoqëria civile.

Mbledhja e VII

Me 31.07.2015 është mbajtur mbledhja e VII (Shtatë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për aprovimin e Raportit të buxhetit të komunës për periudhën janar-qershor 2015;
3. Vendimi për Aprovimin e Rregullores për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve të shkollave të mesme të larta të komunës së Kaçanikut;
4. Propozim Vendimi për dhënien e Pëlqimit kompanisë projektuese inxhinierie ndërtimore SH. A. "P&I" nga f. Elezaj, për ndërtimin e Hidrocentralit 2.4 MW në vendin, Kriva Reka në Z.K. Kaçanik;
5. Vendimi për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajjtshme të komunës, në përbërje:

- | | |
|----------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|
| 1. Kadri Krivenjeva, | anëtar i KK nga PDK; |
| 2. Raif Kasa, | anëtar i KK nga LVV; |
| 3. Ukshin Qallaku,
kryetari i komunës; | anëtar nga ekzekutivi i komunës, i caktuar nga kryetari i komunës; |
| 4. Hamëz Berisha,
kryetari i komunës; dhe | anëtar nga ekzekutivi i komunës, i caktuar nga kryetari i komunës; dhe |
| 5. Mirlinda Hysa, | anëtar nga shoqëria civile. |

6. Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, shkollave, dhe
7. Vendimet për plotësimin e Komiteteve obliguese të Kuvendit; Komitetin për Politikë dhe financa, dhe Komitetin e Komuniteteve, me nga një anëtar.

7.1. Komiteti për Politikë dhe Financa plotësohet me anëtarin, Avni Tafili në vend të Hajdar Lokut i cili ka ofruar dorëheqje nga ky komitet.

7.2. Komiteti për Komunitete, plotësohet me anëtarin, Pranverë Loku, në vend të Kadri Krivenjeva, i cili ka ofruar dorëheqje nga ky komitet.

Mbledhja e VIII

Me 29.09.2015, është mbajtur mbledhja e VIII (Tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për miratimin e Buxhetit të komunës, për vitet, 2016-2018;
3. Vendimi për Aprovimin e Rregullores për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2016;
4. Aprovohen 14 Vendime për mbrojtjen e vlerave të natyrës:
 1. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të trungjeve të bungut(Quercus sp) në fshatin Bob si monument i natyrës , / Lënda: 01.Nr.16-30553/15;
 2. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të trungut të qarrit (Quercus cerris) në Kaçanik të Vjetër si monument i natyrës, / Lënda: 01.Nr. 16-30556/15;
 3. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të trungut të qarrit (Quercus cerris) në Kaçanik të Vjetër si monument i natyrës, / Lënda : 01.Nr. 16-30558/15;
 4. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të trungjeve të dushkut (Quercus sp) në Kaçanik të Vjetër si monument i natyrës, Lënda : /01.Nr. 16-30559/15;
 5. Për mbrojtjen e vlers së natyrës të trungjeve të dushkut (Quercus sp) dhe qarrit (quercus cerris) në fshatin Runjevë si monument i natyrës, / Lënda: 01.Nr. 16-30571/15;
 6. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të trungjeve të dushkut Quercus sp, në fshatin Ivajë, si monument i natyrës , / Lënda: 01.Nr. 16-30561/15;
 7. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të trungu i shelgut (Salix - alba), në Kaçanik si monument i natyrës. / Lënda: 01.Nr. 16-30568/15;
 8. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të trungut të dushkut (Quercus sp.) në fshatin Kotlinë si monument i natyrës , / Lënda: 01.Nr. 16-30562/15;
 9. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të trungut të qarrit (Quercus cerris) në fshatin Kovaçec si monument i natyrës, / Lënda: 01.Nr. 16-30564/15;
 10. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të kompleksit të pishave në fshatin Strazhë si pejsazh i mbrojtur,Lënda: 01.Nr. 16-30567/15;
 11. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës " Guri i Zi", në fshatin Llanishtë, si monument i natyrës, Lënda: 01.Nr. 16-30575/15;
 12. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës "Guri i Gjatë" në fshatin Stagovë si monument i natyrës. / Lënda: 01.Nr. 16-30576 /2015;
 13. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës humnera në Shpatin e Qenares në fshatin Gllloboçicë, si monument i natyrë, / Lënda: 01.Nr. 16-30578/2015;
 14. Për mbrojtjen e vlerës së natyrës "Shpella e Shullanit", në fshatin Sllatinë si monument i natyrës, Lënda: / 01.Nr. 16-30579/2015.
5. Vendimi për aprovimin e Planit të Veprimit për rekomandimet zbatuese në raportin vjetor të auditimit 2014; dhe
6. Vendimi për formimin e komisionit për rishikimin e procesit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale në territorin e komunës së Kaçanikut, sipas Kërkesave dhe shqetësimeve të qytetarëve.
 - 1.Kemal Mërseli, anëtar i kuvendit,
 - 2.Kadri Krivenjeva, anëtar i kuvendit,
 - 3.Nazife Krasniqi, anëtare e kuvendit,

- 4.Fatos Koxha..... nga ekzekutivi i komunës, i caktuar nga kryetari i komunës, dhe
5.Burim Çaka.....nga ekzekutivi i komunës, i caktuar nga kryetari i komunës.

Mbledhja e IX

Me 30.10.2015, është mbajtur mbledhja e IX (Nëntë) të Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Aprovohet Raporti i buxhetit të komunës për periudhën, janar-shtator 2015;
3. Vendimi për aprovimin e Planit për Ri-integrimin e personave të ri-atëdhësuar; dhe
4. Njoftohet me Informatën për përfundimin e vitit shkollor 2014/ 2015.

Mbledhja e X

Me 30.11.2015, është mbajtur mbledhja e X të Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Aprovohet Rregullorja për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre; dhe
3. Vendimi për themelimin e vendgjuetive të përbashkëta në komunën e Kaçanikut.

Mbledhja e XI

Me 28.12.2015, është mbajtur mbledhja e XI të Rregullt e Kuvendit të Komunës, udhëhequr nga Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2016;
3. Vendimi për aprovimin e Rregullores për Ndryshim plotësimi e Rregullores 01Nr. 16-3317/15 për pagesën e tarifave, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale, të datës 30.01.2015; dhe
4. Vendimi për refuzimin e e Kërkesës së Basri Kodra, të parashtruar në emër të subjekteve politike opozitare të përfaqësuar në kuvend, me përjashtim të LDK, për nxjerrjen e një Deklarate në emër të Kuvendit të Komunës, për kundërshtimin e dy Marrëveshjeve të nënshkruara nga qeveria e Republikës së Kosovës, 1. Asociacionit- e quajtur Zajednica, dhe 2. Demarkacionit.

MBLEDHJE SOLEMNE

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, gjatë vitit 2015, ka mbajtur tri mbledhje me karakter Solemn dhe atë; me datë 17.02.2015, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Me 11.06.2015, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Çlirimit të Komunës dhe më datë 10 Gusht 2015, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Dëshmorëve të Komunës.

DEBATE PUBLIKE

